

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 717 Prot.

Tiranë, më 04.07 2016

VENDIM Nr. 75, datë 28.06.2016

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë"(i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.8 të datës 28.06.2016, pasi shqyrtoi *Relacionin mbi Metodikën e Studimeve Gjeoteknike me anën e shpimeve për linjën e gazsjellësit, në kuadër të projektit "TAP", propozimin për kryerjen e sondimeve gjeoteknike në këtë zonë*, paraqitur nga Kompania "SPIECAPAG ENTREPOSE"- "Spiecapag Shqipëria" mbështetur në VNMS e miratuar të zonës,

VENDOSI:

1. Të miratojë Relacionin mbi Metodikën e Studimeve Gjeoteknike me anën e shpimeve për linjën e gazsjellësit, në kuadër të projektit "TAP", propozimin për kryerjen e sondimeve gjeoteknike në këtë zonë, paraqitur nga Kompania "SPIECAPAG-ENTREPOSE"- "Spiecapag Shqipëria", mbështetur në VNMS e miratuar të zonës.
2. Kompania "SPIECAPAG-ENTREPOSE"- "Spiecapag Shqipëria" duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me shoqëri të licencuar në arkeologji, e cila duhet të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të sondimeve gjeoteknike, si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë shoqëri.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015 dhe përcaktimeve përkatëse të kontratës tre palëshe.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Ëbsite: asha.gov.al